

## Historia e Permetit

Saturday, 10 November 2007

Permeti shtrihet ne juglindje te Shqiperise. Rrethi i Permetit perbehet nga dy bashki, e Permetit dhe Kelcyres, dhe nga 7 komuna, Suke, Ballaban, Petran, Carshove, Piskove, Frasher e Deshnice. Perbehet nga 13.000 banore dhe ka 3000 familje.

Emigrimi eshte nje nga proceset qe ka prekur Permetin, dhe sot ka rreth 2500 emigrante te cilet ane kryesisht ne Greqi. Megjithate ajo ç'ka gjithashtu eshte verejtur eshte levizja e banoreve nga fshatrat e treves per ne Permet, gje qe e ben ate te banuar vetem nga Permetare, ne rrenje te tille. Permeti eshte nje qytet malor, per vete faktin se rrethohet nga nje varg malor, vargu Trebeshine-Dhembel-Nemercke. Permes qytetit kalon lumi i Vjoses, qe eshte bere pjese e pandashme e emrit te ketij qyteti. Eshte nje qytet i vogel nga siperfaqja por jo i tille nga traditat e kulturat. Emri i tij vjen nga nje hero i lashtesise, i quajtur Premt, historia e te cilit ka ardhur deri ne ditet tona, brez pas brezi. Thuhet se per te mos rrene ne duart e armiqve, Premti vendosi te hidhej nga "Guri i Qytetit", nje shkemb i madh afer qendres se Permetit, nje monument qe vete natyra ia pati dhuruar, i vecante, ose me mire i jashtezakonshem. Nje karakteristike tjeter e Permetit kane qene lulet, me sakte trendafilat qe gjendeshin kudo neper qytet, sidomos neper lulishte, por gjithashtu neper shtepite me origjine tevjeter permetare, shtepi private te mbajtura aq paster nga zonjat e shtepive, qe vec nikoqirlekut shquhen gjithashtu per mikpritje. Ishin keto lule qe e bene te quhej me perkedheli si "Qyteti i trendafilave". Permeti eshte nje nga qytetet me te hershem qe zhvilloi kulturen e vet. Mjafton te permendim te madhin Mentor Xhemali, nje yll te muzikes shqiptare qe rrjedh nga ky qytet, per te vazhduar me pas me Laver Bariun, qe edhe ne ditet e sotme, dhe pse ne nje moshe te madhe, ndjen akoma pergjegjesi per te cuar perpara muzikenpermetare, per te ngritur keshtjellen themelet e se ciles u hodhen vite me pare. Por nuk eshte vetem muzika ajo qe formon kulturen e Permetit. Nuk mund te harrohen poezite e te famshit Naim, lindur ne Frasher, nje fshat i Permetit, qe si perla te cmuara vazhdojne edhe ne ditet e sotme te jene te kerkuara nga lexuesit, vazhdojne te jene pjese e teksteve te leximit letrar apo letersise. Ka edhe emra te tjere qe mund te vazhdojne te perzgjedhim nga shkrimtaret shqiptare me ne ze, vendlindja e te cileve eshte en Permet, psh. Bardhyl Londo apo Sejfulla Malshova. Qyteti i Permetit ka vetem dy shkolla 8-vjecare, Nonda Bulka" e "Meleq Gosnoshti", si dhe gjimnazin, "Sami Frasheri". Dallohet per tolerancenfetare, dhe ne gjirin e tij kane bere strehe besimetorthodhokse e myslimane, dhe kohet e fundit edhe disa besime te reja, te huaja si pershembullai Evangjelist. Nje hap perpara per kete qytet ishte formimi i nje televizioni me nje emer sinjifikativ: AOS TV, ne gushte te 2004, duke u dhene me teper mundesi permetareve te informohen per gjithcka qe ndodh ne kete rreth. Nqs do te krahasohej me Permetin e viteve me pare, Permeti sot do te dukej pa vlere. Qe pas '97 Permeti pesoi shkaterrim si cdo qytet tjeter, pasojat e se cilit ende vazhdojne te ndihen ndopak, pershkak te fondeve te pakta qe u derdhen per kapercimin e asaj gjendjeje, por kjo do te thote se vlerat e ketij qyteti kane humbur. Nqs do te beheshin pak me teper investime, Permeti do arrinte nivelin e vet, nje nivel te denje ashtu sic i ka hije, por per kete kerkohet ndihma e te gjitha atyre qe thelle ne veten e tyre ndihen ende permetare, e te gjitha atyre qe kane mundesi te bejne dicka per ta mbajtur emrin e Permetit ashtu sic duhet.